



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-24627/22 datë: 23.08.2022



Npi – 01/265 datë: 29.08.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 29.08.2022 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 29.08.2022 (e hënë) në ora 10:00 h. në sallën e Kuvendit

Në mbledhje kan marrë pjesë, Kryesuesi: z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj znj.Saniye Sadiki, (znj.Heroina Selmani, on-line). Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati, zyrtar kryesor financiar, z.Shpëtim Gashi, zyrtar për informim, z.Shqiprim Hyseni, praktikantë. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet e KPF-së të mbajtura më: 27.04.2022, 27.05.2022, 23.06.2022, 05.07.2022,
2. Shqyrtimi i Listës së Kërkesave Npi-01/223,
3. Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025,
4. Raporti i Kontrollit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, nga Zyra Kombëtare e Auditorit (ZKA),
5. Raporti Vjetor nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJB),
6. Zgjedhja e Komisionit për Ndryshimin e Rregullores për bashkëpunimin e komunës me fshatrat dhe lagjet urbane. Npi – 01/89 datë: 27.03.2015,
7. Propozim-Vendim për emërtimin e Shkollës Profesionale sipas Vendimit të MASHT-it Nr.2-3726 dt.28.08.2019 “Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional”.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet e KPF-së të mbajtura më: 27.04.2022, 27.05.2022, 28.06.2022, 05.07.2022,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalet nga mbledhjet e KPF-së, të mbajtura më: 27.04.2022, 27.05.2022, 28.06.2022, 05.07.2022.**

Pika 2

Shqyrtimi i Listës së Kërkesave Npi-01/223

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ju e dini që këto kërkesa janë shtyrë edhe në mbledhjet e kaluara, ne bashkërisht do ta formojmë një komision për këtë, mendoj se nuk ka nevojë që ta zgjasim më shumë por ta shtyjmë deri në formimin e Komisioneve.

z. Përparim Ramusa; Pajtohem që kjo pikë të shtyhet, dhe ti rekomandojmë Kuvendit që ta formojmë një komision për këtë.

znj.Adelina Beqaj; Unë rekomandoj që këtu të ceken këto kërkesa për emërtimin e objekteve publike, kërkesat tjera duhet të diskutohen këtu në Kuvend.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Kërkesat secila duhet të ketë një rekomandim nga Ekzekutivi.

z.Përparim Ramusa; Kërkesa me numër 20 e z.Avdullah Msuliut, mendoj se duhet të ketë një përjashtim, pasi që ai kërkon që të ndahet një fond për mirëmbajtjen e dy monumenteve "Kulla e Lirisë" dhe Shkronjat e UÇK-së, të vendosura nalt në kodër, kështu që unë propozoj që ti rekomandojmë Kuvendit që me planin buxhetor të ndahet një bugjet për këtë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Këtu duhet të jetë rekomandimi nga Drejtoria e Urbanizmit.

z.Përparim Ramusa; Nuk na duhet një herë rekomandimi i Drejtorisë së Urbanizmit.

z.Lumni Amrushi; Sa i përket kërkesës të z.Avdullah Musliut, duhet me përkrah, të njëjtën kohë duhet me arritur edhe një kërkesë nga banorët e fshatit Pjetërshticë, se edhe atje është e njëjta situatë me Shtabin e UÇK-së dhe me Shkronjat e UÇK-së. Unë mendoj se duhet të shkojë si pako, mandej rruga duhet të hyjë te investimet kapitale, kërkoj që zyrtari financiar të na tregoj ku mundemi me e futë si projekt.

znj.Adelina Beqaj; Ka një numër të madh të kërkesave, duhet të na shpjegojnë se si t'i rekomandojmë Kuvendit. Kemi kërkesën e z.Bahri Rexhës nga Petrova e cila mjaftë është zgjatur, duhet ta kemi të qartë se kërkesat duhet të marrin epilog..

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Do t'i bëjë presion sekretarisë që të ja dërgojë me kohë Ekzekutivit listën e kërkesave dhe pastaj ata të na rekomandojnë se si të procedojmë me këto kërkesa.

z.Përparim Ramusa; Përfundimisht, mendoj që të gjitha këto kërkesa duhet të shtyhen me përjashtim të kërkesës të z.Avdullah Musliut e cila duhet të shkoj si rekomandim.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, që të gjitha kërkesat të shtyhën, me përjashtim të kërkesës së z.Avdullah Musliut, derisa të zgjidhet një Komisioni për Shqyrtimin e këtyre kërkesave.**

Pika 3

Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Shkurtimisht do ta prezantojë Planin Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025, ku finalin e këtij, do ta paraqesim në Shtatorë. Në pika të shkurta e kamë shtjelluar pjesën e Grandeve, projeksionin e të hyrave dhe shërbimeve (shih në dokumentin) Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025.

Ndarja është bërë duke u bazuar në Qarkoren Buxhetore 2023-2025, numri i stafit ka ndryshuar, te kodi buxhetor Mallra dhe Shërbime nuk ka ndryshuar. Shpenzimet komunale janë rritë, (shih dokumentin) Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025. Te administrata, numri i stafit është 109. Në krahasim me vitin 2021 e keni në dokument një pasqyrë që thotë se ka rritje të Buxhetit, ku Subvencionet janë rritë, por edhe kategoria e pagave është rritë. Lista e

projekteve kapitale ende nuk ka përfunduar. Ky draft ka me shkuar në diskutim publik, e atje do ti marrim propozimet dhe sygjërimet, e ato që mundë të kemi mbulese me fonde, do t'i fusim në këtë draft-dokument.

z.Përparim Ramusa; E kuptoj rekomandimin që duhet ti bëhet Kuvendit, por kamë disa pyetje: Numri e punëtorëve në shëndetësi a ka ndryshua në krahasim me vitin e kaluar?

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Ka rritje për 8 persona në staf, duke përfshirë mjek, motra dhe staf shtesë.

z.Përparim Ramusa; Pajtohem që të dërgohet si rekomandim, Kuvendit.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025.**

Pika 4

Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, nga Zyra Kombëtare e auditorit (ZKA)

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Sa i përket Raportit të Auditorit për vitin e përfunduar më 31.12.2021, nga ZKA, tani e kemi këtë material para vetës, nuk ka nevojë për votim, por e kemi sjellë këtu për tu njoftuar me këtë raport. Ne kemi me filluar me mbajtjen e takimeve me publikun për këtë. Ky është një material mjaft i gjerë, ku përmban opinionin e Auditorit, gjetjet, informimin, progresin, rekomandimet si dhe letrën që kanë përfunduar raportin e kontrollin në përputhje me ligjin për kontrollin. Fillimisht opinionin është "i pa modifikuar" për pasqyrat financiare, ku përfshin kontabilitetin dhe raportet tjera. ZKA është e pavarur nga subjekti i kontrollit, për të parë me rend gjetjet ju rekomandoj që të shihni dokumentin: "Raporti i Auditorit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021", nga Zyra Kombëtare e Auditorit (ZKA), që e kemi marrë, ky është raport që bëhet nga ZKA prandaj nuk kërkon votim, sepse në të nuk mund të ndryshojmë asgjë, kështu që ju propozoj që të dërgohet në Kuvend, kështu si është pikë për pikë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që dëgjuam zyrtarin financiar z.Bujar Feratin i cili na e shtjellojë në pika të shkurta raportin mendojë edhe kjo pikë e rendit të ditës duhet ti shkojë Kuvendit si e tillë. Hapi diskutimin a e dëshironë dikush fjalën për këtë pikë. Si gjetje e Auditorit a ka ndërmarrë ekzekutivi diçka për mi korigju këto.

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Sa i përket gjetjeve 3 janë në proces kurse 8 tjera janë eliminuar, kemi bërë ekipin e punës, dhe kemi bërë planin e veprimit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; A ka dikush tjetër që dëshiron me marr fjalën.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht ka vendosur se për këtë pikë nuk ka rekomandim për Kuvendin.**

Pika 5

Raporti Vjetor nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJB)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Edhe për këtë pikë ja kaloj fjalën Zyrtarit Financiar z.Bujar Feratit që ta prezantojë "Raportin Vjetor nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJB)".

z.Bujar Ferati, zyrtarë kryesor financiar; Para juve kemi dokumentin për këtë pikë, të cilin e kemi marrë me kohë, por megjithatë po ua lexoj në pika të shkurta gjetjet që i ka ky raport. Ky raport ka pjesën e përgjithshme nga njësia qendrore, ndërsa njësia e auditimit të brendshëm është formuar sipas Ligjit të Auditimit, që i raporton zyrës së Kryetarit të Komunës. Auditimi duhet të kryhet nga një auditor i brendshëm e në këtë rast në komunën tonë janë dy auditor. Ndërsa nëse nuk ka auditor të brendshëm duhet të kontraktohet një kompani profesionale për kryerjen e këtyre punëve. Te plani i auditimit po lexojë: "Duhet të ketë auditim, i pari duhet të ketë 3, dhe i dyti poashtu 3 deri në dhjetor", numri i auditorëve 2 me 2. Auditor të rekomanduar janë 3. Propozime janë 6, të dhëna janë 17, të zbatuara janë 5, ndërsa 6 janë në proces.

z.Përparim Ramusa; Auditimi i brendshëm është punë e Zyrës së Kryetarit, nuk e kisha pa të arsyeshme me diskutuar më gjatë, pasi që është detyrë e zyrës së Kryetarit.
***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht ka vendosur se Raporti vjetor nga njësia e auditimit të brendshëm, është punë e Zyrës së Kryetarit të Komunës.**

Pika 6

Zgjedhja e Komisionit për Ndryshimin e Rregullores për bashkëpunimin e komunës me fshatrat dhe lagjet urbane, Npi – 01/89 datë: 27.03.2015,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Janë bërë disa ndryshime në Udhëzimin Administrativ, ç'do njëzet mijë banorë do të ketë 12 zona, kështu që jo secili fshat ka kryetarë, duhet të fuzionohen, kjo është ajo çka do të ndryshohet, do ta bëjmë një komision, sipas disa takimeve që kemi pasur me Kryesuesit e Komunave tjera, unë do të ja jap një draft komisionit si model që të procedojnë tutje.

z.Përparim Ramusa; Jemi të obliguar me përkrahë këtë pikë, kurse qelësin e diskutojmë në Kuvend.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendimit për themelimin e Komisionit për Ndryshimin e Rregullores për bashkëpunimin e komunës me fshatrat dhe lagjet urbane, Npi – 01/89 datë: 27.03.2015.**

Pika 7

Propozim-Vendim për emërtimin e Shkollës Profesionale sipas Vendimit të MASHT-it Nr.2-3726 dt.28.08.2019 në "Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional".

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Është në vendim të MASHT-it, i cili na obligon me bërë këtë ndryshim. Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Përparim Ramusa; Jemi "pro" propozimit, sepse edhe vendimi i MASHT-it na obligon.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Po e hedhim në votim këtë propozim-vendim.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Vendim për emërtimin e Shkollës Profesionale sipas Vendimit të MASHT-it Nr.2-3726 dt.28.08.2019 "Institucion i Arsimit dhe Aftësimi Profesional".**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 11:13h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

